ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Prishtinë: 20.12.2013
Kodi i ZRRE-së: V_594_2013

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1043_10_13;**
- Ankesa e KEDS-it e datës 31.10.2013.

në seancën e mbajtur më datë 20 dhjetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

I **REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për parashtruesin e ankesës H.H., (shifra e konsumatorit DPR - 22690) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi**.**

II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1043_10_13 i datës 10.10.2013.

Arsyetim

Parashtruesi i ankesës me datë 29.09.2011 ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kërkuar që të bëhet shlyerja e borxhit të papaguar deri në nënshkrimin e kontratës së shitblerjes me datë 25.08.2011.

Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 23.09.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit duke u mbështetur ne dokumentet e siguruara si Ankesa e konsumatorit për shlyerje të borxhit të energjisë elektrike, protokolli mbi dorëzimin e çelësave i datës 08.04.2004, kërkesën për rishqyrtimin e shpenzimit te energjisë elektrike si dhe kontratën e shitblerjes se pronësisë.

Konsumatori pas përgjigjes së KEDS-it ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 10.10.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: 1) të shkarkoi nga borxhi i energjisë elektrike të shifrës DPR - 22690 e cila evidentohet në emër të M.B. që përfshin periudhën deri me datën e nënshkrimit të kontratës më datë 25.08.2011; 2). borxhin e krijuar në shifrën DPR – 22690 sipas pikës 1 të këtij vendimi ta kërkoj përmes procedurës gjyqësore nga personat të cilat e kanë krijuar atë borxh të energjisë elektrike; dhe 3). pas marrjes së veprimeve në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi obligohet që shifra DPR-22689 të kaloi nga emri i M.B. në emër të pronarit të ligjshëm të shtëpisë H.H.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 31.10.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se nuk ka bazë për korrigjim të borxhit deri më datën 08/2011 ngase pranimi për dorëzimin e çelësave është bërë me datë 25.07.2005 dhe se atë e ka bërë B.M. i cili me asnjë provë nuk dëshmohet se në çfarë raportesh është me M.D. Në ankesë theksohet se KEDS-i në asnjë rast nuk ka pranuar kërkesë për shkyçje siç e parasheh procedura nëse ai nuk ka banuar aty dhe nuk ka asnjë provë se kush ka qenë shfrytëzues i energjisë elektrike në atë shifër pas pranimit të çelësave nga ana e AKP-së.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pretendimet e KKDFE-së se nuk ka bazë për korrigjim deri me datën 08/2011 nuk qëndron, pasi që konsumatori ka prezantuar kontratën e shitblerjes së pronësisë dhe se sipas kontratës së shitblerjes së pronësisë së datës 25.08.2011 pronar legjitim nga ajo datë është H.H., ndërsa më herët sipas kontratës pronar legjitim ka qenë B.M. dhe B.M. dhe se duhet theksuar se kontrata e shitblerjes së pronësisë është e vërtetuar në gjykatën komunale në Prishtinë. Përveç kontratës së shitblerjes së pronësisë, konsumatori ka siguruar edhe disa shkresa nga Agjencioni Kosovar i Pronave, si shkresa e datës 21.09.2011 dhe Protokolli mbi dorëzimin e çelësave i datës 25.07.2005, në të cilën shihet qartë se ish-pronari i kësaj shtëpie B.M. ka bërë pranim-dorëzimin e çelësave të shtëpisë me ç'rast është evidentuar se kjo pronë është shfrytëzuar nga persona në mënyrë të paautorizuar dhe evidentohet emri i një personi Hasan Krasniqi i cili ka shfrytëzuar këtë pronë deri me ketë periudhë kohore.

Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës e posaçërisht analizimit të kontratës së shitëblerjesë së pronësisë 25.08.2011, e cila kontratë është lidhur ndërmjet shitësve B.M. dhe B.M. nga Prishtina në njërën anë dhe blerësit H.H. nga fshati Bërnicë KK Prishtinë në anën tjetër, ka vërejtur se në nenin 6 të kontratës së shitblerjes së pronësisë është theksuar se shpenzimet e energjisë elektrike deri më datën e nënshkrimit të kontratës i bart shitësi. Andaj me ketë rast Bordi i ZRRE-së konstaton se KEK, me rastin e pranimit të kësaj kontrate nga konsumatori ka qenë e obliguar të bëjë prerjen e borxhit dhe të njëjtin ta kërkoi nga personat që e kanë krijuar.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se asnjëherë nuk kanë pranuar kërkesë për shkyçje të energjisë elektrike sipas procedurave dhe se nuk ka asnjë provë se kush ka qenë shfrytëzues i energjisë elektrike pas pranimit të çelësave nga AKP, duhet theksuar se sipas analizave të bëra rrjedhës së energjisë elektrike aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se nga periudha 08/2002 e deri më datën 27.11.2006, KEK-u nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për shkyçje të konsumatorit nga rrjeti elektrik, por e ka lejuar të krijohet dhe grumbullohet borxhi i energjisë elektrike dhe se atë borxh të energjisë elektrike nuk ka arritur ta inkasoj, si dhe duhet theksuar se kjo shifër nga periudha 10/2002 e deri në periudhën kohore 03/2011 shihet se konsumatori është faturuar pa matje/paushall. Pra, KEK-u gjatë kësaj periudhe është dashur të fillon procedurë gjyqësore për të kërkuar borxhin e energjisë elektrike nga personat të cilët e kanë shfrytëzuar pronën e konsumatorit ashtu që të mos lejojë që të grumbullohet ai borxh edhe më tutje. Kjo gjendje ka vazhduar edhe më tutje pra edhe gjatë nënshkrimit të kontratës së shitblerjes së pronësisë. Bordi i ZRRE-së konsideron se mosveprimet e marra nga ana e KEK-ut në atë periudhë kur është krijuar borxhi i energjisë elektrike dhe mos inkasimi i tij nga ana e shfrytëzuesve para lidhjes së kontratës nga konsumatori, nuk mund t'i ngarkohen pronarit të ligjshëm pasi që edhe dispozitat ligjore nuk e lejon ketë veprim

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1043_10_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të

të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

_____
Enver Halimi, kryesues

_____
Përparim Kabashi, anëtar

_____
Blerim Koci, anëtar

_____
Merita Kostari, anëtare

_____
Krenar Bujupi, anëtar